



Prishtinë: 22.12.2010

Kodi i ZRRE-së: V_326_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_508_12_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 14.6 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_508_12_10**;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2010 nxori këtë:

VENDIM

APROVOHET pjesërisht ankesa e konsumatorit Skyfter Elshani, Separacioni “Egzoni”, nga fshati Piranë si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK të ZRRE-së të 03.11.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 10.10.2008, lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 30.07.2007 konsumatori ka parashtruar kërkesë zyrtare në KEK, Distriktin e Prizrenit, duke kërkuar nga KEK-u që të dalin punëtorët e autorizuar të KEK-ut në objektin e Separacionit Egzoni pasi që grupi matës nuk ka punuar.
Provë: Procesverbali i KEK-ut i datës 30.07.2007
- Me datë 07.03.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me një korigjim nr.9830 DPZ-9023831-0 në vlerë prej 9,876.10 €.
Provë: Korigjimi nr. 9830 DPZ-9023831-0 të datës 18.04.2005
- Me datë 24.04.2008 KEK-u ka korigjuar konsumatorin duke zbritur nga borxhi i përgjithshëm një vlerë prej 2,863.20 €.
Provë: Korigjimi nr. 9830 DPZ-9023831-0 të datës 18.04.2005

- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në KEK, Departamentin për Konsumatorë duke kundërshtuar ngarkesën e bërë nga KEK-u dhe korrigjimin e bërë.
- Me datë 10.10.2008 KEK-u ka korrigjuar konsumatorin duke zbritur nga borxhi i përgjithshëm një vlerë prej 983.50 €.
Provë: Korrigjimi nr. 11762 DPZ-9023831- 9023831 të datës 18.04.2008
- Me datë 10.10.2008 Departamenti për Konsumatorë në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e pranuar ankesën e konsumatorit Separacioni “Egzoni” në arsyetimin se pasi që konsumatori nuk ka pasur gjendjen të rregullt në pikën matëse konsumatori është llogaritur me mesatare sipas korrigjimit nr. 9830 të datës 07.03.2008 në vlerë financiare prej 9876.10 €. Me ankesën e konsumatorit KEK-u ka bërë korrigjimin nr. 10025 të datës 24.04.2008. Pasi që konsumatori nuk është pajtuar me korrigjimin lënda prapë është rishqyrtuar. Korrigjimin e kemi bazuar në atë se shpenzimi mesatar për periudhën 05.2007 deri 09.2008 në bazë harxhimit nga viti paraprak 05.206 deri 09.2006 është 6,029.40 €. Konsumatori do të ngarkohet për periudhën me defekt të njehsorit me shumën $9876.10 - 2863.20 - 983.50 = 6029.40$ €.
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 10.10.2008
- Me datë 03.11.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit dhe KEK-ut, ka vërejtur se:

- ✓ Konsumatori në kërkesën zyrtare të parashtruar në KEK me datë 30.07.2007 ka kërkuar nga KEK-u që të inspektohet pika matëse e objektit Separacioni “Egzoni”, pasi që pika matëse nuk është duke punuar.
Provë: Kërkesa e e konsumatorit e parashtruar në KEK me nr. 3805 të datës 30.07.2007
- ✓ Punëtorët e autorizuar të KEK-ut me datë 28.09.2007 kanë bërë ndërrimin e grupit matës të konsumatorit Separacioni “Egzoni”, ku është larguar nga matja grupi matës nr. 32060338 dhe është vendosur për matje grupi matës nr. 285783.
Provë: Procesverbali – protokoli nr. 553 i datës 28.09.2007
- ✓ Sipas procesverbaleve të leximit të periodës 06/2007 dhe 07/2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar se njehsori në prishje qe tre muaj; sipas procesverbaleve të leximit me nr. 007121 për periudhën 10/2007, procesverbalit nr. 0010361 për periudhën 11/2007 dhe procesverbalit nr. 0011846 për periudhën 12/2007 punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë evidentuar se është bërë ndërrim njehsori.
Provë: Procesverbalet e KEK-ut nr. 007121, nr. 0010361 dhe nr. 0011846
- ✓ KEK-u edhe pse me datë 28.09.2007 ka bërë ndërrimin e grupit matës, ku kanë larguar nga matja grupi matës nr. 32060338 për shkak të dëmtimit dhe kanë vendosur për matje grupin matës nr. 285783, nuk e kanë regjistruar menjëherë në program (CCP). Sipas transaksioneve të konsumatorit dhe faturave të energjisë elektrike vërehet se fatura e parë konsumatorit me grup matës nr. 285783 konsumatorit i ka arritur në periudhën 12/2007. KEK-u në këtë rast është vonuar në regjistrimin me kohë të grupit matës

- ✓ Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se në muajin e 5/2007 kur punëtorët e autorizuar të KEK-ut kanë bërë leximin e pikës matëse kanë hasur në njehsorin elektrik me defekt, të cilët kanë lajmëruar njësitin e Prishtinës, të cilët menjëherë kanë njoftuar njësitin e Prizrenit por që punëtorët e KEK-ut nuk kanë inspektuar pikën matëse me kohë. Sipas konsumatorit deri në muajin shtator të vitit 2007 KEK-u nuk ka dalur për të inspektuar pikën matëse dhe për të evituar defektin e njehsorit elektrik. Pasi është bërë ndërrim i njehsorit elektrik KEK-u ka faturuar konsumatorin në vlerë 9786.10 €, e cila shumë është llogaritur për shtatë muaj. Konsumatori ka theksuar se firma Egzoni disa herë ka parashtruar disa herë kërkesë me shkrim si dhe ka qenë disa herë në KEK për të paraqitur rastin. Pas ankesave KEK-u ka zvogëluar shumën nga shtatë muaj në 5 muaj, pra nga shuma 9876.10 € në shumën 7012.88 €, pra është zbritur vlera prej 2863.20 € për periudhën 05/2007 deri më 11/2007. Por prapë Separacioni Egzoni ka parashtruar ankesë në KEK dhe se prapë KEK-u ka bërë edhe një korrigjim, nga shuma 7012.88 € ka zbritur vlerën 6029.40 €, pra janë zbritur 983.48 €. Separacioni Egzoni ka marrë nuk është pajtuar edhe me këtë vlerë ngase shpjegimi i KEK-ut dhënë konsumatorit thekson se janë marrë për bazë të kësaj llogaritje muajt paraprak të njëjtë të vitit 2006 (5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2006). Firma Egzoni për këtë periudhë ka shumën 3479.08 €. Firma Egzoni ka parashtruar ankesë për muajt 1, 2, 3, 4, 5 të vitit 2006 për shkak të reduktimeve të shpeshta. Shuma e kësaj periudhe është e përbashkët, por që kam marrë përgjigje negative dhe e nuk kam parashtruar ankesë. KEK-u me shumën prej 6029.40€ të muajve 5,6,7,8,9 të vitit 2006 ndërsa te firma Egzoni nuk ekziston kjo shumë për këtë periudhë, shuma që ekziston në firmën Egzoni është 4925.43 € për periudhën 5,6,7,8,9 të vitit 2006. Firma Egzoni thekson se pse nuk merren muajt 5,6,7,8,9 të vitit 2008, ngase ato të vitit 2006 kanë pasur punë më të madhe në krahasim me vitin 2007, dhe viti 2007 ka pasur punë më madhe se viti 2008. Sipas Firmës Egzoni muajt 5,6,7,8,9 të vitit 2008 është harxhuar shuma prej 4116.17 €. Firma Egzoni nuk është fajtor për mos angazhimin me kohë të punëtorëve të KEK-ut për të evituar defektin.

Provë: Ankesa e konsumatorit

- ✓ KEK-u pasi që ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë prej 9876.10 € ka bërë dy korrigjime: korrigjimi i parë ka ndodhur me datë 24.04.2008, ku KEK-u ka korrigjuar vlerën prej 2863.20€ dhe korrigjim i dytë ka ndodhur me datë 10.10.2008 në vlerë 983.50 €. Vlera e ngarkuar nga ana e KEK-ut prej 9786.10 €, ka ndodhur ashtu që KEK-u mbledhur të gjitha faturat nga muajt 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 të vitit 2006. Vlera e korrigjuar nga ana e KEK-ut prej 2863.20 € e datës 24.04.2008 me numër 10025DPZ-9023831-0 ka arritur si rezultat pasi që KEK-u ka marrë shpenzimin e njëjtë për muajt 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11 të vitit 2006 dhe këta muaj i ka faturuar me çmime të vitit 2007. Vlera e korrigjuar e datës 10.10.2008 me numër 11762DPZ-902383-1 ka arritur pasi që KEK-u ka vërejtur se në korrigjimin e mëparshëm ka bërë një lëshim ngase shpenzimet e muajit maj të vitit 2006 kanë arritur si rezultat i grumbullimit të shpenzimeve prej muajit janar 2006 e deri te muaji maj të vitit 2006. Pasi që ka korrigjuar këtë vlerë KEK-u me datë 10.10.2008 ka korrigjuar edhe vlerën prej 983.50 € nga ngarkesa e përgjithshme prej 9876.10 €. Pra sipas llogaritjes së KEK-ut të bërë me datë 10.10.2008 është vërejtur se KEK-u ka marrë të gjitha shpenzimet e bëra për muajt 05/2006 deri 09/2006 dhe duke e faturuar me çmime të vitit 2007, dhe se KEK-u në këtë korrigjim ka theksuar se KEK-u është dashur të faturoj konsumatorin në vlerë prej 6029.40 €. Sipas kësaj llogaritje edhe ka rrjedhur korrigjimi i bërë i KEK-ut.

Provë: Korrigjimet e bëra nga ana e KEK-ut me datë 24.04.2008 dhe me datë 10.10.2008

- ✓ DMK ka analizuar korrigjimet e bëra nga ana e KEK-ut dhe ka vërejtur se korrigjimi i bërë i datës 10.10.2008 në vlerë prej 983.50 €, ka vërejtur se KEK-u gjatë llogaritjes së bërë shpenzimet e energjisë aktive dhe reaktive i ka marrë të njëjta si në muajt 5, 6, 7, 8, 9, të vitit

2006, por që fuqinë maksimale (maksigrafin) KEK-u e ka marrë duke marr vlerën maksimale të periudhës 03/2007 dhe se me këtë vlerë edhe ka faturuar konsumatorin.

- ✓ DMK gjatë analizave të bëra konstaton se KEK-u duhet të merr për bazë q shpenzimet e energjisë aktive dhe reaktive të merren ato të muajve 5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2006, me përjashtim që shpenzimet e grumbulluara për muajin 05/2006 të bëhet shpërndarja (01-05/2006) të cilën e ka bërë edhe vet KEK-u në korrigjimin e datës 10.10.2008. Duhet që edhe vlera e maksigrafit të jetë e njëjta si në muajt 5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2006 dhe se edhe vlera e maksigrafit për muajin 05/2006 të shpërndahet proporcionalisht prej 01 – 05/2006.
- ✓ DMK ka vërejtur se në muajin e 12/2007 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me faturë në vlerë financiare prej 3004.68 €. Kjo faturë ka arritur si grumbullim i kilovatëve të bëra për muajt 10/2007 dhe 11/2007.
Provë: Transaksionet e konsumatorit, kërkesa e konsumatorit në KEK me datë 30.07.2007
- ✓ DMK sipas analizave të konstaton se vlera të cilën KEK-u është dashur të faturojë konsumatorin për 5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2007 është 5578.93 €, pra duke marrë shpenzimet për muajt 5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2006 por duke e ngarkuar me çmime të vitit 2007. Sipas analizave të bëra të DMK del se mesatarja e faturave për këta muaj është 1115.78 €, që përputhet me mesataret e faturave të vitit 2008 dhe 2009.

DMK duke u bazuar në analizat e cekura më lartë, rekomandon Bordin e ZRRE-së që të **aprovjë pjesërisht** ankesën e konsumatorit dhe kërkon nga KEK-u që:

1. Korrigjimi i cili duhet t'i bëhet konsumatorit për periudhat 5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2006 duhet të jetë 5578.93 €.

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet dhe argumentet e paraqitura dhe pas analizës së lëndës së konsumatorit ka vendosur që të **aprovjë pjesërisht** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së.

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Korrigjimi i cili duhet t'i bëhet konsumatorit për periudhat 5, 6, 7, 8, 9 të vitit 2006 duhet të jetë 5578.93 €.

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar